



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:155240
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05716302

Ac.nr.994/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevci, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Z.R., A.R., Sh.R., S.R., S.R., F.R., R.R., S.R. dhe M.R., që të gjithë nga Podujeva, cilët sipas autorizimit i përfaqëson B.J., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.U.G.A.”, sh.a, me seli në Prishtinë, Rr. “...”, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësve, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.432/2011 të datës 24.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditësve Z.R., A.R., Sh.R., S.R., S.R., F.R., R.R., S.R. dhe M.R., që të gjithë nga Podujeva, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.432/2011 i datës 24.12.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.432/2011 të datës 24.12.2020, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve Z.R., A.R., Sh.R., S.R., S.R., F.R., R.R., S.R. dhe M.R., që të gjithë nga Podujeva, me të cilën kanë kërkuar që: “të aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve Z.R., A.R., Sh.R., S.R., S.R., F.R., R.R., S.R. dhe M.R., që të gjithë nga Podujeva dhe të detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit për dhimbjet shpirtërore të përjetuara me rastin e humbjes së jetës së babait të paditësve pas aksidentit të pësuar me datë 09.11.2011, t’ua kompensoj këto shuma: për secilin paditës shumën e kompensimit në nivelin 6000 euro, në emër të shpenzimeve të varrimit shumën 2000 euro, në emër të ngritjes së përmendores shumën prej 1000 euro. Pra kërkohet aprovimi në emër të dëmit jo material në shumën e përgjithshme 57,000.00 euro, duke përfshirë njohjen e interesit për palën paditëse sipas normës së interesit të cilën për çdo vit e përcakton autoriteti

bankar BQK për mjetet e afatizuara deri në një vit si dhe shpenzimet e specifikuar në precizimin e kërkesëpadisë në vlerë të përgjithshme prej 6,118.00 euro”. Secili pjesëmarrës në procedurë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë kanë paraqitur paditësit nëpërmjet të autorizuarit të tyre, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë me datë 22.12.2011, kanë kërkuar që të detyrohet e paditura për kompensimin e dëmit material dhe jo material, në shumë prej 57,000.00 euro, të shkaktuara me rastin vdekjes së babait të tyre pas aksidentit të të pësuar me datë 09.11.2011.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave të paraqitura nga palët duke arsyetuar se nuk është kontestuese se me datën 09.11.2011, rreth orës 10:40 minuta, në rrugën “...”, në Podujevë, ka ndodhur aksident komunikacioni të cilin e ka shkaktuar e siguruar tek e paditura me ç’rast tani i ndjeri A.R. (babai i paditësve), në cilësinë e këmbësorit ishte duke kaluar rrugën dhe ka pësuar lëndime të rënda trupore si pasojë e aksidentit. Kontestuese në këtë çështje ishte baza e kërkesëpadisë ku paditësit pretendojnë se babai i tyre tani i ndjeri A.R., ka vdekur me datën 24.11.2011, si pasojë e lëndimeve të pësuar në aksident ndërsa sipas ekspertizës mjekësore të punuar nga grupi i ekspertëve dr. M.G., specialist i mjekësisë ligjor, dr. M.H., specialist i ortopedisë-traumatologjisë dhe dr. D.H., specialist i mjekësisë ligjore, në bazë të mendimit të tyre rezulton se babai i paditësve-tani i ndjeri ka pësuar lëndime: ndrydhje të indeve të buta në pjesën koksofemorale të kofshës dhe thyerje të kockës së kofshës, së majtë në nivel të trohantereve, të shkaktuara nga mjeti i fortë si pasojë e aksidentit në trafik, duke konstatuar se lëndimet e pësuar paraqesin dëmtime të rënda trupore por në momentin e shkaktimit nuk janë të rrezikshme për jetën, duke ardhur në përfundim se nuk është kryer autopsia me anë të së cilës përcaktohet shkaku i vdekjes dhe në mungesë të saj shkaku është i panjohur dhe duke pasur parasysh moshën dhe problemet shëndetësore (për të cilat arsye nuk është operuar thyerja), nuk përjashtohet mundësia që vdekja e të ndjerit të jetë natyrore, duke mos përjashtuar kështu as mundësin që vdekja të ketë ardhur si pasojë e embolisë. Sipas grupit të ekspertëve nuk mund të përcaktohet lidhja kauzale shkak-pasojë në mes të dëmtimeve të pësuar në aksident dhe vdekjes së tani të ndjerit A.R.. Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur lidhur refuzimin e kërkesëpadisë konform nenit 154, 173,177, paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së,

ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës ka vendosur sipas nenit 449, 450 dhe 451 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë konkludimin e saj e ka bazuar në ekspertizat mjekësore, pasi që në rastin konkret rezulton se gjykata e shkallës së parë plotësisht i ka vërtetuar faktet të cilat kanë qenë me rëndësi vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore dhe për këto fakte në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqit arsye të plota, sepse nga të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilat janë elaboruar në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, nuk rezulton se e paditura është e detyruar që paditësve t’iu kompensoj dëmin material dhe jo material, pasi që sipas ekspertëve nuk mund të përcaktohet lidhja kauzale shkak-pasojë, në mes të dëmtimeve të pësuar në aksident dhe vdekjes së tani të ndjerit-babait të paditësve, ndërsa sipas dispozitës së nenit 154, paragrafi 1 të LMD-së, (ligji i RSFJ i cili ka qenë në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit), përcaktohet se: “*Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësve sipas të cilave gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar si duhet gjendjen faktike duke i falur besimin supozimeve shkencore ndërsa nuk ka marr parasysh konstatimet e ekspertëve se nuk mund të përjashtohet aksidenti dhe lëndimet e rënda si shkaktar i vdekjes. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjshëm ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve, duke marr parasysh shkresat e lëndës. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se pala paditëse nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për të argumentuar padinë dhe me rastin e shqyrtimit të lëndës Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë këtë konstatim. Sipas dispozitës së nenit 322, paragrafi 2 të LPK-së përcaktohet se “*Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër*”, me ç’rast paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kanë prezantuar ndonjë provë në bazë të cilave të do bëhej i besueshëm pretendimi i tyre lidhur me kompensimin e dëmit nga e paditura, meqë nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar se nuk eksiton lidhja kauzale shkak-pasojë e dëmit përkatësisht vdekjes së të ndjerit A.R.-babai i paditësve.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.994/2021, me datë 16.05.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.